



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:086635  
Datë: 26.11.2024  
Numri i dokumentit: 06510831

**2024:086636**

**Gjykata Themelore në Ferizaj**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B dhe L.M.B, të cilët i përfaqëson av. Vllaznim Aliaj nga Ferizaj, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve SIGAL me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seance me datë 26.11.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Konstatohet e tërhequr padia** me shenjen 2023:086636, e paditësit A.B dhe L.M.B, kundër të paditurit Kompania e Sigurimeve SIGAL me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

**A r s y e t i m**

Paditësit, të cilët i përfaqëson av. Vllaznim Aliaj nga Ferizaj kanë ushtruar padi në këtë gjykatë më dt. 18.03.2024, kundër të paditurit, për çështjen objekt kontesti kompensim dëmi.

Përfaqësuesi i paditësve av. Vllaznim Aliaj nga Ferizaj me parashtrësën e dt.22.11.2024, e ka njoftuar gjykatën se e bën tërheqjen e padisë pasi me të paditurin kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore. Meqë në gjykatë nuk ka mbërritur përgjigja në padi e të paditurit, gjykata nuk ia dërgoi parashtrësën e paditësve për deklaram të njëjtit.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm**

**Datë 26.11.2024**

**Gjyqtari,**  
**Armend Ahmeti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.